D E K R E T
Nr.1505, datë 7.6.1996

PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSAT DOGANORE TË MAKINERIVE DHE PAJISJEVE TEKNOLOGJIKE TË IMPORTUARA PËR PASTRIMIN E QYTETIT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

D E K R E T O J:

Neni 1

Përjashtohen nga taksat doganore të importit të gjitha makineritë dhe pajisjet teknologjike që janë importuar dhe do të importohen nga shoqëritë e kontraktuara me sipërmarrje prej Bashkisë së Tiranës, vetëm për qëllimin e pastrimit të qytetit, në përputhje me kontratat e nënshkruara ndërmjet palëve para datës 1 janar 1996.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet e tij financiare prej datës 1 janar 1995 deri në vlefshmërinë e kontratave për të cilat bëhet fjalë në nenin 1 të këtij dekreti.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha